

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Beqir Kalludra, me gjyqtaret profesional Shadije Gërguri dhe Shpresa Hasaj-Hyseni, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores Mybera Latifi, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit H.H, nga P, rr. 'Z P' pn., për shkak të veprës penale Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së ish-Prokurorisë Komunale në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.548-2/10 të dt.22.04.2011, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor me dt.13.01.2017, në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Besa Limani dhe i akuzuari, të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari H.H, i biri i H dhe F, e gjinisë H, i lindur më *data e lindjes*, në fshatin O, komuna e P, tani me vendbanim në P. rr. 'Z P' pn., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal *numri personal*.

ËSHTË FAJTOR

Sepse

Me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, me dt.22.01.2009 në P, në rr.'2 Q', në parkun e Paqes 'M, i akuzuari H.H, i cili punonte si menaxher i këtij parku në cilësinë e personit zyrtar, ka përvetësuar pajisjet elektrike dhe atë, një saldues harkor, një saldues të vogël, dy retifika, një turjelë, një kompresor, një sharë disk me këmbalec, një sharrë për hekur, një motor-sharrë, një makinë për fshirjen e gjetheve, një ventilator, një friz, një mbajtëse për persona me aftësi të kufizuara, dhe para të gatshme në vlerë prej 3.400,00 euro pronë e të dëmtuarës –organizatës 'M', pa ndonjë autorizim dhe në emër të kësaj organizate, të cilat para gjendeshin në xhirollogarinë e N Bankës, me ç'rast i ka shkaktuar dëm të konsideruar material të dëmtuarës,

-me këtë ka kryer veprën penale Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 3, 34, 42, 43, 44, 64, 66, 67 dhe 340 par.2 të KPK-së si dhe nenit 359, 365, 367, 368, 450, 453 dhe 463 par.2 të KPPRK, e:

GJYKON

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë, shumën prej 30 (tridhjetë) €, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës organizatës M, P G, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Ish-Prokuroria Komunale tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP.nr.548-2/10 të dt.22.04.2011, kundër të akuzuarit H.H, për shkak të veprës penale Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, me dt.13.01.2017, dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari, e ka pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale me të cilën është akuzuar.

Prokurori i shtetit nuk ka pas vërejtje në deklaratën e të akuzuarit për pranimin e fajësisë.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetojë se në veprimet e të akuzuarit H.H, manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, ashtu që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fund ka deklaruar se meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, i ka propozuar gjykatës, që me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, që ta merr parasysh pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e zhvillimit të kësaj procedure penale dhe gjendjen e rëndë ekonomike, ashtu që këto rrethana ti vlerësoj si rrethana lehtësuese.

I akuzuari H.H i ka propozuar gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë të çfarëdo lloj sanksioni penal, si rrethanë lehtësuese ta vlerësoi pranimin e fajësisë, shprehjen e keqardhjes dhe pendimin e thellë për këtë veprim, si dhe gjendjen e vështirë ekonomike, i njëjti është i papunë dhe mbajtës i vetëm i familjes, dhe gjendjes së rëndë shëndetësore të vajzës së tij me domosdoshmëri për trajtim jashtë vendi, premtimin se në të ardhmen nuk do ti përsërit veprime

të tilla të ngjashme, andaj e ka lut gjykatën që mundësisht t'ia shqiptoj një sanksion sa më të butë të mundshëm penal.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 64, 66 dhe 67 të KPK-së, andaj si rrethanë veçanërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e sinqertë të fajësisë dhe kohën e kaluar nga momenti kur është kryer kjo veprë penale, pra më tepër se 8 vjet, derisa si rrethanë lehtësuese vlerësoi sjelljen dhe qëndrimin e tij shumë korrekt në gjykatë, pendimi i thellë i tij për këtë veprë penale, premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do ti përsëris asnjëherë këto veprime, gjendjen e rëndë ekonomike, se i njëjti është i papunë dhe mbajtës i vetëm i familjes, e në mungesë të rrethanave rënduese të akuzuarit ia shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 42 të KPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marrë duke pas për bazë faktin se i dëmtuari nuk ka qenë prezent në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ku i akuzuari e ka pranuar fajësinë, e po ashtu deri më tani me asnjë parashtrësë paraprakisht nuk e ka precizuar kërkesën në mënyrë të qartë, duke mos ia bashkangjitur provat konkrete, ashtu që të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurve për gjykim të plotë e as të pjesërishtë lidhur me këtë çështje, konform nenit 463 par.1 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.153/13, dt.13.01.2017

Procesmbajtësja
Mybera Latifi

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Beqir Kalludra

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.